

**Raport Final i Akreditimit
Ekipi i Ekspertëve të Jashtëm
Universiteti Kadri Zeka i Gjilanit 2014**

Raporti i Vlerësimit

Nga ekipi i ekspertëve,
I cili vlerëson Universitetin "KadriZeka" në Gjilan
Në procesin e akreditimit institucional nga Agjencia e Kosovës për
Akreditim
9 Prill, 2014

TABELA E PËRMBAJTJES

1. PREAMBULA	3
2. VLERËSIMIT	5
2.1. Deklarata e Misionit	
5	
2.2. Liria Akademike	7
2.3. Programet Akademike dhe Menaxhimi i Studentëve	8
2.4. Hulumtimi	9
2.5. Bashkëpunimi Ndërkombëtarë	11
2.6. Stafi	12
2.7. Organizimi, Menaxhimi dhe Planifikimi	14
2.8. Financat dhe Infrastruktura/ Hapësirat dhe Pajisjet	15
2.9. Menaxhimi i Cilësisë	18
3. PROGRAMET E STUDIMIT	20
3.1. Fakulteti Juridik	20
3.1.1. Bachelor në Juridik (LLB)	
20	
3.2. Fakulteti Ekonomik	28
3.2.1. Banka, Kontabilitet dhe Financa (BSc)	28
3.2.2. Marketing (BSc)	30
3.2.3. Administrim Biznesi (MBA)	31
3.2.4. Menaxhment dhe Informatikë (BSc)	33
3.3. Fakulteti i Shkencave Politike	41
3.3.1. Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci	
41	
3.4. Fakulteti i Shkenave Kompjuterike	
45	
3.4.1. Shkenca Kompjuterike (BA)	45
4. PORPOZIMET PËR AKREDITIM	52

1. PREAMBULË

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), anëtare e ENQA ka pranuar kërkesën nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës për të akredituar Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan (UGJ), si dhe programet e studimit në tri fakultetet: Juridik, Ekonomik dhe Shkenca Politike. Për të bërë vlerësimin e Universitetit AKA ka emëruar një grup ekspertësh:

- Prof.Dr. Salvador Rus-Rufino/ Universiteti i Leon (ES) (Kryesues)
- Prof.Dr.MihaSkerlavaj/ Shkolla Norvegjeze e Biznesit (NO) dhe Universiteti i Lubjanës (SI)
- Prof.Dr. Eduardo Vendrell Vidal/ Universiteti i Teknologjisë së Valencias (ES)
- Prof. Dr. Norbert Kapferer/ Universiteti Freie në Berlin (D)

Gjatë procesit të vlerësiit ekspertë kanë marrë parasysh udhëzuesit e AKA-së për vlerësimin e programeve akademike. EE ka vizituar gjithashtu hapësirat dhe ndërtesat e UGJ-së. Rektori i Universitetit ka bërë një prezantim për UGJ-në dhe në fund kemi mbajtur dy takime të tjera, njërin me studentët dhe tjetrin me stafin akademik, përfshirë koordinatorët e programeve. Për këtë qëllimë shtë realizuar vizita e organizuar nga AKA për 8 Prill 2014.

Sipas Kodit të Prktikës së mirë për vizita në Institucione dhe sipas Udhëzuesve për Ekspertë (Institucionet dhe Programet Akademike), të rishikuara nga AKA, ekipi i ekspertëve ka shkruar raportin e vlerësimit në vijim.

Raporti i vlerësimit është bazuar në Raportin e Vet Vlerësimit të Universitetit të muajit Prill 2014, dhe në bazë të të gjeturave të ekspertëve gjatë vizitës në institucion dhe takimeve të mbajtura në universitet.

Pikat referuese për raportin e vlerësismit janë standardet ndërkombëtare të institucioneve të krahasueshme të arsimit të lartë dhe standardet e rishikuara nga AKA.

AKA ka kërkuar nga ekspertët që të vlerësojnë programet dhe Fakultetet si dhe të dorëzojnë një raport i cili i është dërguar institucionit që ata ti paraqesin argumentet e tyre. Vendimi i

ekspertëve është në pjesën 3 të raportit dhe është i bazuar në bazë të të gjeturave, të cilat janë të përshkruara në pjesën e dytë të raportit.

Në draft raportin ekspertët kanë formuar disa rekomandime. Megjithatë disa nga këto rekomandime janë kritike për akreditimet e ardhshme, atëherë kur UGJ të ketë ëgjegjësinë e plotë për të gjitha lëndët.

2. VLERËSIMI

2.1 Deklarata e misionit

Qeveria e Kosovës ka themeluar Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan në vitin 2013 në mënyrë që të promovojë arsimin e lartë në regjionin e Gjilanit si dhe në Luginën e Preshëvës. Më herët këto tri fakultete, ishin të vendosura në Gjilan, dhe funksioninin si dgë të Universitetit të Prishtinës.

UGJ ka pesë Fakultete me programe të studimit: Fakulteti i Edukimit (FED); Fakulteti Juridik (FJu); Fakulteti Ekonomik (FEK); Fakulteti i Shkencave Kompjuterike (FSHK) dhe Fakulteti i Shkencave Politike (FSHP).

Misioni i universitetit është *"Arsimimi i studentëve me arritje moderne në shkencë, teknologji, kultivimin e shpirtit ndërmarrës dhe kreativ të studentëve, ndjenjën e ligjshmërisë dhe drejtësisë si dhe aftësimin e tyre për tu përballur me sfidat e ardhshme në këtë botë dinamike dhe vazhdimisht në ndryshim."*

UGJ ka ndërtesat e veta të cilat më herët ishin si tri fakultetet e degëve të Universitetit të Prishtinës. Duket se ka një marrëveshje në mes të qeverisë për të ndërtuar edhe një kampua tjetër ë mnëyrë që Universiteti të mund të ketë më tepër hapësira për mësimdhënie dhe posacërisht për punë kërkimore.

Misioni dhe objektivat janë të definuara mirë dhe tentojnë të bëjnë universitetin një institucion referues në Kosovë për mësimdhënie dhe hulumtim, si dhe të shërbjenë si aktor kryesor për rritjen e ekonomisë në regjion.

Gjilani, me më shumë se 130000 banorë gjatë viteve të fundit një qytet i rëndësishëm industrial në Koosvë. Së fundmi, një inkubator i ri i biznesit në qytet është themeluar me mbështetjen e Agjencisë Evropiane të Rindërtimit dhe kështu UGJ do të ketë mundësi më të mëdha të bashkëpunimit me të.

UGJ ka një strategji për të arritur misionin e aprovuar nga Senati i tij. Kjo strategji përfshin një varg të elementeve të cilat janë të përkufizuara mirë, mirëpo duket se janë shumë të gjera dhe shumë

ambicionze, sa i përket burimeve aktuale si dhe realitetit politik dhe ekonomik në Kosovë. Gjithashtu, këto elemente janë më tepër se një plotësi e qëllimeve të cilat nuk lidhen me asnjë veprim konkret.

Vetëm nëse potenciali i institucionit është i qartë, sepse ka shumë sfida të cilat janë shumë ngushtë të lidhura me qëllimet e misionit të institucionit të cilat mund të vëstrësojnë implementim e këtyre elementeve.

Planet strategjike për universitetet marrin kohë për tu hartuar dhe për tu zbatuar, madje edhe për institucionet me repute.

Rekomandime:

- Të themelohet një Këshill Konsultativ i cili mund të përbëhet nga anëtarët e Universitetit si dhe nga anëtarët të cilët përfaqësojnë Qeverisjen Lokale, Industrinë dhe Aktorët social. Këshilli Konsultativ duhet të jetë në krye të hartimit të një qasje reale për jithë elementet e planit strategjik, ta ripërkufizojë planin strategjik nëse është e nevojshme, dhe të bëjë përshtatjen e veprimeve në mënyrë që gjitha qëllimet të mund të arrihen.
- Të fokusohen në qasjen ndër- diciplonore në mënyrë që të ketë dallime në mes të mësimdhënies dhe hulumtimit si dhe të bëhet dallim në mes të institucioneve të tjera arsimore në Kosovë. Kjo qasje mund të jetë fokus i tërheqjes së studentëve në të ardhmen e afërt të cilët mund të vijnë nga regjionet e tjera.

2.2. Liria Akademike

Liria në hulumtim dhe mësimdhënie duket se është përkufizuar mirë përmes programeve të ndryshme të studimeve në UGJ. Edhe pse shumica e programeve vijnë nga fakultetet të cilat veqse kanë të theluara më herët dhe kanë vepruar si deë të Universitetit të Prishinës, ka plane që të hartohen edhe programe të reja (Shkenca Kompjuterike, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci) përmes fakulteteve të reja.

Me sa duket, rregulloret e universitetit nuk kufuzojnë mësimdhënien dhe punën kërkimore kur të bëjnë hartimin e programeve të studimit.

Gjithsesi, liria akademik nuk është e lidhur vetëm me rregulloret dhe duhet të varet nga hapësirat si dhe nga stabiliteti i stafit akademik. Disa pyetje lindin në lidhje me dy aspekte: A ka ndonjë plan për të blerë apo për të freskuar materialet e mësimdhënies dhe mobliet? A ka ndonjë plan për të ndërtuar salla të ligjëratave për studentët apo vende të tjera ku ata do të mund të takohen dhe të ndërveprojnë es vete? A ka plane të vazhdueshme për të krijuar grupe të hulumtimit të cilat udhëhiqne nga stafi permanent akademik? A kanë këto grupe të hulumtimit burime të mjaftueshme (buxhet, materiale, hapësira) për të realizuar aktivitetet e tyre?

Shumica e këtyre pyetjeve nuk janë përkufizuar mirë mirëpo mbesin vetëm dhësira.

Rekomandimet:

- Të përkufizohet një plan real për të themeluar grupe të hulumtimit të cilat lidhen me temat prioritare tematike. Këto grupe të hulumtimit do të mund të lidhen me profesorët permanent relevant, të cilët mund të jenë udhëheqës të vërtetë dhe përgjegjës për zhvillimin e aktiviteteve dhe veprimeve.
- Të organizohen hapësirat dhe pajisjet e nevojshme në mënyrë që të identifikohen qartë degët akademike (mësimdhënia dhe hulumtimi). Në këtë mënyrë studentët dhe profesorët si dhe personat të tjerë mund të identifikojnë aktivitete dhe qëllimet e vazhdueshme të Universitetit.
- Të vendosen rregullore në mënyrë që të impenentohen aktivitetet e mësimdhënies dhe hulumtimit, në mënyrë që të bëhet njonja e e mjaftueshme për secilin individ i cili përfshihet këtu. Në këtë aspekt, do të ishte e dobishme krijimi i një indeksi i cili do të mund të vlerësonte mësimdhënien dhe hulumtimit, në mënyrë që profesorët të mund të ndjehen si të njohur për aktivitete te tyre. Ky indeks, i pajtueshëm nga ana e Ajencisë së Kosovës për Akreditim, mund të përdoret si një parametër për promovim.

2.3. Programet akademike dhe Menaxhimi i Studentëve

Programet akademike korrespondojnë me deklaratën e misionit të Insitucionit dhe me parimet e punësueshmërisë. Cilësia, Rangu dhe Qëllimet Akademike të kurrikulës janë të përshtatshme me gradat akademike të cilat ofrohen nga institucioni. Ka disa dyshime, që këto programe, nëse një koncept didaktik është komunikuar në mnëyrë adekuate tek studentët.

Gradat akademike korrespondojnë me standardet ndrkombëtare, mirëpo struktura e programeve ju ofron pak mundësi të mjaftueshme për studime të pavarura, reflektive dhe analizë.

Caktimi i ECTS-ve nuk është shumë i qartë dhe transparent; ngarkesa për programet akademike është shumë e madhe për studentët. Metodot e mësimdhënies dhe përmbajtjet e njësive mësimore po ashtu janë më pak të mjaftueshme për aritjen e suksesshme të qëllimeve të përgjithshme të programit. Rregulloret e provimeve janë ndikuar negativisht nga kjo dhe si rezultat nuk janë të përshtatshme.

Dyfishimi i përmbajtjes akademike në mes të kurrikulave të ndryshme nuk është i mjaftueshëm, gjithpërfshirës dhe transparent.

Rekomandimet:

- Duhet të ketë pjesëmarrje më të mirë dhe të institucionalizuar të studentëve gjatë përgatitjes së programeve të studimit, rekrutimit të stafit akademik, si dhe çështjeve të tjera menaxheriale s dhe përfshirje më të mirë në aktivitete e hulumtimit.
- Struktura e programeve të studimit duhet të japin më tepër mundësi për studime të pavarura, reflektive dhe analiza.
- Caktimi i ECTS-ve duhet të bëhet në një mënyrë më të qartë dhe transparente. Ngarkesa për programet akademik të studentëve duhet të zvogëlohet. Metodot e mësimdhënies dhe përmbajtja e njësive mësimore duhet të përmirësohet.

- Dyfishimi i përmbajtjes akademike në mes të kurrikulave duhet të bëhet në mënyrë më gjithërfshirëse dhe transparente.

2.4. Hulumtimi

Universiteti ka disa profesorë full time; prandaj niveli i hulumtimit, sipas standardeve evropiane është i ulët, sepse shumica e stafit akademik i cili jep mësim vjen nga Universiteti i Prishtinës dhe se ata bëjnë hulumtim në universitetin e tyre.

Në aën tjetër, procesi i krijimit dhe zhvillimit të grupeve stabile të hulumtimit në projektet e veta të hulumtimit është diçka që merr kohë dhe se kërkon planifikim të qartë dhe real, dhe i cili kërkon që të definohen linjat e hulumtimit nga profesorët e fakulteteve të Universitetit: Edukim; Juridik; Ekonomi; Shkenca Kmpjuterike dhe Shkenca Politike. Institucioi duhet gjithashtu të krijojë grupe të hulumtimit dedikuar zhvillimit të disa programeve të ktyre fushave. Universiteti gjithashtu duhet të merr mbështetje financiare në mënyrë që të investojë në këto grupe, së pkau për tre apo katër vite.

Universiteti është i ri dhe dyhet të ketë burimet në dy mënyra. Së pari si institucion publik në konkurset konkurruese. Së dyti, institucionet private të cilat dëshirojnë të investojnë në zhvillimin e programeve të hulumtimiti përmes të cilave përfiton universiteti si dhe kompania.

Është vërejtur se ka disa profesorë të cilët janë duke bërë hulumtim jashtë universiteit apo në kontakt me profesorët nga institucionet e tjera të arsimit të lartë apo institucionet e hulumtimit. Kjo është një pikë e cila duhet shpejtë të përmirësohet, sepse përndryshe cilësia në mësimdhënia do të vuan shumë. UGJ është duke përmirësuar marrëdhëniet me gурpet e tjera evropiane të hulumtimit; *EE rekomandon që të bëhet punë e mëtejme në këtë aspekt si dhe të shikohen universitetet evropiane dhe amerikane për ekipe të hulumtimit në mënyrë që të krijohen projekte të përbashkëta të hulumtimit*

Studentët nuk janë të përfshirë në hulumtim përpos në disa raste shumë të vogla të praktikave konkrete të Arsimit dhe të revistave të publikuara nga Fakulteti Juridik, mirëpo ata nuk bashkëpunojnë për detyra të hulumtimit, ndër arsytet e tjera, për shkak se kjo do të thotë se duhet të kompensohet mungesa e tyre e dedikimit.

Një aspekt i posacëm kritik është mungesa e bibliotekave, materialeve për exim si dhe burimeve të tjera online nëmnyrë që të mbliidhet dhe të zhvillohet puna kërkimore. Institucioni me të vërtetë nuk ka biblioteka apo qasje në databza, nuk ka kataloge bibliografike, revista, biblioteka virtuale, etj. qka do të mund të përmbushnin këtë boshllëk.

Rekomandime:

- Të zhvillohet një dokument me pesë programe të definuara mirë për punë kërkimore në të cilët mund të përfshihen profesorë sa më shumë që të jetë e mundur.
- Të gjejnë burime për të financuar këso projekte të hulumtimit nga entitetet publike dhe private.
- Të krijohet mbështetje për studentët të cilët marrin pjesë në projektet e hulumtimit dhe se ky dedikim i tyre është kompatibil me oraret e institucionit.
- Së pari, brenda një viti, duhet të themelohet një bibliotekë e hulumtimit me sa më shumë burime elektronike që është e mundur e të cilat do të lehtësojnë hulumtimin bibliografik si deh materialet hulumtimuese.

2.5. Bashkëpunimi ndërkombëtarë

Universiteti ka dia marrëveshje me universitetet e tjera dhe se ao janë të kufizuara me universitetet në Shqipëri deh Turqi. Institucioni nuk ka marrëveshje me universitetet në Bashkimin Evropian dhe me universitetet e Shyteve të Bashkuara. Këto marrëveshje do të mund të ndihmonin me përvojën e tyre dhe me mjetete e tyre në mnëyrë që të përmirësohet mësimdhënia dhe puna kërkimore në universitetin e Gjilanit.

UGJ ka nënshkruar një marrëveshje me Sociacionin e Kolegjeve të Great Lakes në SHBA. UGJ duhet të përdorë këtë mundësi që të

hartojë një plan të zhvillimit i cili përfshin programe të shkëmbimit për studentët dhe profesorët.

Ekspertët nuk vlerësojnë planin strategjik të institucioni sepse sipas tyre nuk është i përkufizuar, real dhe preciz. Në të nuk janë vendosur asnjë prioritet, mungon profili i universiteteve me të cilat duhet të krijohet marrëdhënie bashkëpunimi, mungon prioritizimi i fuhave gjeografike, dhe nuk ka të dhëna nëse bashkëpunimet e tilla ndërkombëtare përfshojnë shkëmbimin e studentëve, profesorëve, grupeve të hulumtimit apo materialet e mësimdhënies.

Ky plan nuk ka përkufizuar se cilat do të jenë burimet financiale të cilat do të investohen për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkombëtar. Po ashtu nuk ka informacione se në cilat programe ndërkombëtare do të përfshihet Universiteti.

Institucioni nuk ka një zyrë për marrëdhënie ndërkombëtare dhe prandaj nuk mund të koordinojë planin e ndërkombëtarizimit, he as profesorët dhe studentët vizitorë.

Rekomandimet:

- Të prezantohen brenda një kohe shumë të shkurtër në programet tempus të BE-së, programet Erasmus të shkëmbimit të studentëve dhe profesorëve, si dhe programe të tjera të cilat lehtësojnë mobilitetin.
- Të zhvillohet një plan për ndërkombëtarizimin e universitetit i cili përfshin mobilitetin e profesorëve, studentëve dhe zhvillimin e marrëdhënieve në kuptim të mësimdhënies dhe hulumtimit.
- Të krijohet një zyrë për marrëdhënie ndërkombëtare e cila do të koordinojë gjitha planet strategjike të ndërkombëtarizimit dhe e cila ofron lehtësira për profesorët dhe studentët të qëndrojnë dhe të studiojnë në universitete të tjera.

2.6. Stafi akademik

Institucioni definitivisht nuk a proporcion adekuat nëmes të stafit akademik full time dhe proporcion adekuat të stafit të jashtëm. Nuk ka

profesorë të mjaftueshëm mirëpo staf të jashtëm i cili vjen nga pjesët e tjera të vendit, dhe punojnë si profesorë part time në universitetin e Gjilanit. Ka plane për ndërkombëtarizimin e stafit akademik, mirëpo deri më tani këto plane nuk janë bindëse. Kjo rezulton në atë që institucioni nuk ka projekte reale të tij të hulumtimit në një nivel të lartë akademik. Po ashti ka vetëm disa baskëpunime ndërkombëtare për hulumtim dhe mësimdhënie.

Me disa përjashtime, stafi akademik nuk dëshmon se kanë aftësi të dëshmuara në një nivel të lartë akademik dhe didaktik. Kualifikemt e tyre nuk janë të përshtashme për pozitat të cilat ata mbajnë brenda institucionit sipas kritereve bazë.

Nuk ka proporcion të barabartë në mes të stafit akademik femra.

UGJ ka në nëjërën anë rregullore transparente, konkurruese dhe cilësre për përzgjedhjen dhe punësmen e stafit akademik, mirëpo në anën tjetër ato rregullore nuk janë përdorur deri më tani.

Së fundmi mirëpo jo më së paku e rëndësishme: rëndësia e gjuhës angleze si gjuhë e shkencës për gati gjitha disiplinat dhe komunikimin ndërkombëtarë duhet të thekshet në mënyrë të posacmë në raport. Bisedimet me përfaqësuesit e menaxmentit, stafin akademik dhe studentëve, kanë treguar se – me disa përjashtime të vogla – njohuritë për këtë gjuhë në të gjitha grupet është tepër e vogël apo mungon krejtësisht.

EE konsideron se UGJ udhet të hartojë një plan zhvillimor për të rekrutuar profesorë të niveve të ndryshme cdo vit, derisa institucioni të kompletohet me staf të mjaftueshëm dhe adekuat dhe kështu të sigurojë cilësinë në mësimdhënie.

Rekomandime:

- Është absolutisht e nevojshme që të rekrutohen profesorë të përhershëm në të gjitha Fakultetet (posacërisht për Fakultetin e planifikuar të SHkencvae Politike) e që përfshijnë profesor nga jashtë (BE, SHBA, etj.) në mnëyrë që të krijohen stnadrde ndërkombëtare shkencore dhe që universiteti të ketë një

reputacion të lartë akademik. Po ashtu kjo duhet të behët me qëllim që institucioni të ketë marrëdhënie bashkëpunimi në hulumtim, molitet dhe shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik.

- Menaxhmenti i Universitetit duhet që seriozisht të përpiqet të rris proporcionin e femrave në stafin mësimdhënës dhe të emëroj sa më shpejtë që të jetë e mundur përfaqësuese femra në institucion;
- Duhet të instalohet një program për edukimin e vazhdueshëm për studentët të cilët ende nuk kanë diplomuar dhe për stafin akademik të cilët janë më pak të kualifikuar në mënyrë që të universiteti të përmbush standardet e tij të larta akademike si dhe ato didaktike, të cilat vetë i kanë përkufizuar.
- Rregulloret transparente, konkurruese dhe cilësore për zgjedhjen dhe punësimin e stafit akademik duhet vazhdimisht të përdroen.
- Një universitet i cili është në kërkim të reputacionit ndërkombëtarë duhet të sigurojë se stafi akademik dhe studentë janë të aftë të marrin pjesë në seminare globale shkencore të cilat mbahen në gjuhën angleze. Programe të përshtatsme duhet të hartohen menjëherë në mënyrë që një gjë e tillë të realizohet.

2.7. Organizimi, menaxhimi dhe planifikimi

Në raportin e vet vlerësimit janë shejguar organizimi i universitetit si dhe fushat e përgjegjësive të secilit trup qeverisës të Universitetit. PO ashtu janë shpjeguar sistemi i kontrolleve të vendimeve. Prandaj ne mund të themi se qeverisja është kolegjiale, ka përgjegjësi të ndaraf për marrjen e vendimeve dhe suposojmë se këto procese janë mjaftueshëm transparente dhe informative.

Provë e kësaj është transparenca në përzgjedhjen dhe promovimin e profesoëve si dhe shpallja publike e pozitave të reja për mësimdhënës.

Struktura qeverisëse mund të garantojë cilësinë e programeve të cilat janë veqse janë duke u ofruar dhe të atyre të cilat do të ofrohen së shejti, mirëpo nëse do të ketë programe të reja, ajo cilësi nuk mund të garantohet.

Në strukturën qeverissh është e nevojshme të jetë një komitet në të cilin marrin pjesë parnterë social: sindikatat e tregut, asociacione të bziensit, parti politike dhe institucione të tjera të cilat janë të interesuara për zhvillimin e Universitetit.

Rekomandime:

- Të hartohet në protokoll apo një proces i vendimmarrjes në mnëyrë që të monitorohet vperimi i gjitha trupave qeverisëse të Universitetit.
- Të krijohet një këshill social në mënyrë që universiteti të dëgjojë zërin e shoqërisë dhe i ili këshill merr pjesë në zhvillimin e Universitetit.
- Të mos ofrohen programe të reja akademike për së paku tre apo katër vitet e ardhshme deri sa programet ekzistuese të përfundojnë. Mos hapni asnjë program të ri. Fokusohuni në ofertën e mësimdënies.

2.8. Financat dhe Infratsuktura/ Hapësirat dhe Pajisjet

Infratsuktura aktuale. EE ka vizituar fakultetet e UGJ-së gjatë vizitës më 8 Prill 2014. Hapësirat për mësimdhnëie janë relativisht modeste, sallat e mësimit nuk jaën adekuate për klasa të mëdha (prandaj kufizojnë format interaktive të mësimdhënies dhe mësimarrjes). Gjendja aktuale e hapësirave tregon për një nevojë urgjente që të investohet tepër shumë në hapësirat fizike në mënyrë që të mbështeten përpjekjet zhvillimore të universitetit në themelim e sipër.

Për më tepër, EE është dëhsperuar nga oferta e kufizuar dhe mungea e organizimit të bibli tekës. Një listë me libra në bibliotekë liston 1625 libra në bibliotekë. Megjithatë, shumica e tyre nuk janë të

lidhura me programet nën vlerësim, janë të vjetra dhe janë në gjuhët që shumica e studentëve nuk i kuptojnë. Përpos kësaj, biblioteka nuk ka asnjë katalog të librave në mënyrë që ti lejojë individëve të shikojnë për titujt e librave në përputhje me programet e studimit apo për vitete e publikimit të tyre.

Për më tepër, UGJ nuk i ofron as profesorëve dhe as studentëve qasje nëndonjë databazë shkencore e cila është e nevojshme për punë shkencore në asnjë prej fushave të programeve nën vlerësim. Rektori ka spejguar se UGJ ka blerë 50 kompjuterë të cilët do të përdoren nga studentët. Në dokumentet shtesë të dorëzuara, UGJ ka ofruar një listë të blerjes së kompjuterëve e cila numëronte 15350 euro.

UGJ duhet të konsideroj që të investoj në infrastrukturën e profesorëve dhe studentëve në mënyrë që infrastruktura të jetë faktori më i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm të institucionit dhe në të mënyrë të tërheq staf të kualifikuar dhe studentë.

Financat. Menachmenti i UGJ-së i ka ofruar EE-së me disa dokumente financiare të cilat tregojnë shifra të ndryshme (shtojcë e aplikacionit, planifikimi i buxhetit nga Tetori 2013, dhe relativizimin e të hyrave dhe shpenzimeve në T1 2014).

Si një institucion publik, UGJ varet nga linjat buxhetore të MASHT të Republikës së Kosovës me një buxhet mesatare për vitin 2014 prej 1.5 milion eurove. Prej këtij buxheti, pagat për stafin i afrohen shumicës së kësaj shume (afërsisht 1 milion euro). Kohëve të fundit ka pasur një rritje të buxhetit prej 25% me vendim të qeverisë. Sipas shpjegimeve nga rektori, linja buxhetore do të rritet përputhshmërisht me rrethanat. Tarifat e studentëve (aktualisht 50 euro për studentët e rregullt dhe 250 euro për studentët me korrespondencë) janë më pak të rëndësishme për të hyrat e UGJ-së. Kjo është inkurajuese duke pasur parasysh planin për të zbritur tarifat e studentëve nga qeveria.

Një element kyç për UGJ-në është investimi në hapësirat e reja të cilat EE i konsideron si tepër të rëndësishme për zhvillimin e fakultetit (kjo është njëjloj e rëndësishme sikurse angazhimi i stafit të kualifikuar akademik full time dhe fokusi strategjik i universitetit regional me vlera të dallueshme nga të tjerët). Bazuar në intervistat

me menaxhmentin e shkollë, duket se ka mbështetje politike nga qeveria për të financuar 15 milion euro për ndërtimin e një kapmusi të ri, me sa duket në vitin 2016 dhe 2017. Megjithatë, mund të ketë ende rreziqe në lidhje me investimet pasi që UGJ nuk ishte në gjendje të ofrojë dokumente zyrtare për të treguar dedikimin e qeverisë për të bërë këto investime (si dokumente shtesë, EE ka pranuar një fragment të planit strategjik të UGJ- i cili parasheh investime dyherë më shumë 7.5 milion euro investime ne 2016 dhe 2017).

Rekomandime:

- EE i bën thirrje UGJ-së që të investojë tepër shumë në aktualizimin e fondit të librave të cilat duhet të jenë drejtpërdrejtë të lidhura me programet e studimit të cilat janë në vlerësim. Secili libër në syllabus duhet të ketë së paku një kopje në bibliotekë dhe duhet të aktualizohet në baza të rregullta.
- Të investohet në databaza shkencore të nevojshme për hulumtin e stafit akademik dhe studentëve për programet në vlerësim. Së paku nga një databazë për secilin fakultet duhet të jetë e qasshme nga stafi akademik dhe studentët.
- Të investohet në hapësira të reja të cilat duhet të ndërtohen me fokus me nevojat e procesit edukativ. EE sugjeron menaxhmentin e UGJ-së dhe arkitektët që të punojnë në bashkëpunim të ngushtë me stafin në mënyrë që të ndërtohen hapësira shumë funksionale për qëllime të mësimdhënies. Standardizimi dhe vizitat studimore të disa nga shkollat udhëheqëse evropiane mund të jenë burim i inspirimit ër një gjë të tillë.

2.9. Menaxhimi i Cilësisë

Sipas Deklartës së Bolonjës, UGJ duhet të themelojë një Zyrë për Bashëpunim Ndërkombëtarë dhe Cilësi, *detyra kryesorëve e cilës zyrë duhet të jetë sigurimi i cilësisë në të gjitha aktivitetet akademike.*

UGJ ka përkufizuar disa hapa për hartimin e një plani për sigurimin e cilësië. Kjo procedua është bazuar në tri raporte (ligjërues,

studentë dhe zyrtari i cilësisë). Nga këto raporte, është gjenruar një raport vlerësimi për follderët personal të secilit ligjërues.

Sigurimi i Cilësisë është pak a shumë një proces apo një listë e hapave të cilat duhet të zbatohen. Është një kulturë reale e cila ndahet me gjithë stafin që është i përfshirë në aktivitetet fitore të Universitetit. Shumica e institucioneve të AL nëpër Evropë janë të përfshirë në krijimin apo ngritjen e kulturës së sigurimit të cilësië, dhe stafi i tyre mëson çdo ditë se si të ballafaqohet me detyrat e tij.

Sigurimi i Cilësië për programet e studimit është një nga aspektet kryesore të cilat duhet të merren parasyh. Në këtë mënyrë, universiteti duhet të rrshtohet me Deklaratën e Bolonjës, që i lejon krahasimin e syllabuseve dhe, më tutje, shkëmbimet ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

UGJ ende nuk ka krijuar *procedura për rishikimin e programeve akademik*, mirëpo implemton procedurat e njëjta të cilat përdoren në Universitetin e Prishinës, e cila procedurë është bazike për ndryshimin e programeve të studimit. UGJ është në proces të përkufizimit dhe përcaktimit të mekanizmave për zbatimin e masave të sigurimit të cilësië. Një platformë e TI-së është zhvilluar në mënyrë që të menaxhohen informacionet akademike në lidhje me lëndët dhe programt e studimit.

Rekomandime:

- Të rishikohen dhe të përkufiozhen jitha programt e studimit në mënyrë që të bazohen në një formë reale të kompetencave dhe rezultateve të të mësuarit. Në këtë mënyrë, stafi akademik dhe studentët mund të identifikojnë lehtësisht përmbajtjet dhe qëllimet e secilës lëndë.
- UGJ duhet të punoj në rresht me Agjencinë e Kosovës për Akreditim në mënyrë që të hartojë një rregullore reale për Sigurimin e Cilësisë dhe e cila bazohet në procesin e azhdueshëm i cili siguron monitorimin e veprimeve dhe kundër përgjigjeve. Një raport monitorimi duhet të hartohet për të marrë dëshmi e si po arrihet rezultatet e të mësuarit për secilin progra të studimit. Përmes këtyre raporteve të

monitorimit, do të mund të realizohet sigurimi i cilësisë në mënyrë reale.

- Të zhvillohet një burim i TI-së në mënyrë që të stafi akademik të mund të evidentojë lehtësisht se si kompetencat e mësimdhënies dhe mësimarrjes si dhe rezultatet e të mësuarit janë të lidhura me lëndët. Në këtë mënyrë, një kulturë reale e sigurimit të cilësisë mund të krijohet brenda Universitetit, e cila do të lehtësojë tutje procesin e akreditimit.

3. PROGRAMET E STUDIMIT

3.1. Fakulteti Juridik (vlerësua nga Prof.Dr. Salvador Rus-Rufino)

3.1.1. Bachelor në Juridik (LLB) AKREDITIM

Përshtypja e përgjithshme është pozitive për programin dhe kurrikulëm mirëpo ka disa aspekte negative në lidhje me hapësirat ku fakulteti është i vendosur, financat dhe sa i përket të ardhmes së stafit akademik. Takimi me profesorë ka shërbyer si një mjet për të vërtetuar se ata kanë një ekip të motivuar të profesorëve me projekte për të krijuar një shkollë juridike në Gjilan. I tillë ishte edhe takimi me studentët, të cilat gjithashtu kanë treguar se dëshirojnë të kontrobuojnë në zhvillimin e Fakultetit dhe të zgjidhin problemet që ata kanë.

Megjithatë ka disa probleme të cilët duhet të zgjidhen sa më shpejtë që të jetë e mundur në mënyrë që të sigurohet udhëheqja e mire e Fakultetit Juridik dhe se cilësi e mësimdhëniës përmbush misionin i cili është përshkruar në raportin e vet vlerësimit të Fakultetit Juridik.

Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Në takimin me profesorët u bë e qartë se Fakulteti ka për qëllim të ofrojë trajnime teorike dhe praktike të njëjtën kohë. Kjo do të bëhet në një mënyrë të balancuar si në ligjërata, ashtu sic është thënë në syllabuset e seciës Inndë, po ashtu edhe në raste praktike.

Studentët nuk kishin pranuar nga universiteti trajnime parkime të nivelit të larët dhe gjithashtu nuk kishin mbajtur praktika në institucionet private apo publike.

Në tre vitet e arshme Fakulteti do të merr përgjegjësinë e të gjitha lëndëve në Bachelor të Juridikut. Programi përgjithsisht është në përputhje me programet e tjera të cilat ofrohen në universitetet evropiane apo në shkollat juridike. Konsiderimi i vetëm është se në

UGJ nuk ka praktikë në fund ytë studimeve apo punimin e diplomës në kurrikulë.

Në këtë kohë Fakulteti ka mundësinë që të prezantojë çështje të reja në kurrikulën e tij sikurse bioteknologjia dhe drejtësia, deontologjia, apo specializimet për studentët, ndoshta e Drejta Private, e Drejta Publike apo e Drejta e Ndërmarrësië. Këto iniciativa do të shërbjnë për të ndryshuar kurrikulën e Fakultetit Juridik të UGJ-së nga shkollate tjera juridike në Kosovë

Stafi

Stafi i cili është vlerësuar është mësimdhënës në vitin e parë. Numri i profesoreve duket se është i pamjaftueshëm pasi që ka 13 profesorë për 14 lëndë. Cfarë nuk është e qartë është se profesorët të cilët ligjërojnë në vitin e parë i takojnë UGJ-së dhe Universitetit të Prishtinës. Vitin e ardhshëm do të ketë më tepër profesorë të cilët do të angazhohen në universitet në mënyrë që të përfundohet stafi akademik deri në vitin e katërt. Sido që të jetë, disa profesorë kanë gradën PhD.

Nuk ka asnjë profesor i cili përmendet në program për zhvillimin profesional dhe mëbsteje në mësimdhënie. Ndoshta kjo nuk është urgjente për këtë vit, mirëpo është e nevojshme në dy vitet e ardhshme. Gjithashtu, nuk ka asnjë informatë për kontrollimin, vlerësimin dhe monitorimin e akteve të jashtëm të profesorëve full time.

Balancimi në mes të gjinve në pozitat akademike është jo i saktë. Ka më tepër meshkuj sesa femra. Duhet të krijohen procedura për monitorimin e balancit gjinor në staf për gjithë Fakultetin.

Zhvillimi i fakultetit. Fakulteti ka filluar të veprojë që një vit, megjithatë ka nevojë që të zhvillojë një plan strategjik për zhvillimet e ardhshme. Aktualisht sinjali i vetëm për të mos pasur brenda për të ardhmen e afërt është shpallja e konkursit për profesorë të rinj. Mirëpo kjo nuk mjafton. Fakulteti duhet të mendojë se çfarë do ta ndryshojë të ardhmen e saj nga shkollat e tjera juridike, për shembull, nëse sugjerojmë specializimin e studentëve adresimi i çështjeve të cilat kanë ndikim në të drejtën e rejt, për shembull bioteknologjia, teknologjitë e reja, marrëdhëniet komplekse ndërkombëtare, etj.

Nga këndvështrimi i organizimit të brendshëm, fakulteti ka nevojë që të përkufizojë se sa departamentet duhet të ketë, se si do të organizohen ato, çfarë fusha të njohurive do të organizojnë ato departamente, cili nga ta do të zhvillojë aktivitete për shoqërinë dhe si do të përmirësojnë trajnimin e studentëve, cili do të krijojë marrëdhënie me institucionet e tjera hulumtuese, universitete apo kompani publike dhe private. Asnjë nga këto elemente nuk ekziston, mirëpo thuhet vetëm në nivel deklarativ.

Hulumtimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtarë

Projektet e hulumtimit të Fakultetit janë të fokusura në tri linja kryesore:

- Bazat e sistemit ligjor.
- Ekonomia dhe e Drejta.
- Njohuritë bazike për drejtësinë.

Secili program ka mbështetje afat shkurtër financiare. Është e mjaftueshme për një fakultet me përvojë një vjeçare, mirëpo nuk është e mjaftueshme për një Fakulteti, i cili dëshiron që të luan një rol dallues në të ardhmen. Për të koordinuar aktivitetin huamutes është e nevojshme që të krijohet Pro rektorë për Hulumtim të cilët do të shërbejnë si koordinatorë të punës kërimore të Fakultetit.

Gjithë profesrët e Fakulteti duhet të elbaorjnë një plan tre vjeçar për hulumtim. Do të jetë aktiviteti i tij personal i hulumtimit dhe ai do të vlerësohet cdo tre vite.

Një nga aspektet më kritike për të zhvilluar hulumtim në Fakultetin Juridik është mungesa e një biblioteke të specializuar e cila ka fonde të mjaftueshme për të filluar projektet e hulumtimit. Themelimi i nj biblioteke është çështje e investimit të parve dhe kohës. Mirëpo tani ka disa forma për të ndërprerë investimet dhe kohën. Së pari, mund të kërkon nga universitetet e tjera që të japin si donacion kopje të materialeve. Së dyti arritja e marrëveshjeve për hulumtim me shtëpitë e shtypit që të blihen materialet dhe të shtyhen apo vonohen pagesat. Së treti, të përdoren të dhënat online dhe materiale të tjera. Sëkatërti, arritja e marrëveshjeve të hulumtimit me institucionet

publike apo private për të japur si donacion pjesë të bibliotekave të tyre apo ti bindim ato që biblioteka e Fakultetit Juridik do të jetë edhe biblioteka e tyre. Së pesti, dhe jursitet dhe avokatët me renome mund të japin donacione për fakultetin juridik. Në cdo rast, është e pamundshme që të zhvillohet hulumtimi në Fakultet pa patur bibliotekë apo qasje në burimet online.

Sudentët duhet të kenë mundësinë që të elaborojnë në aktivitetet e huimitmit përmes rivistave të Fakultetit.

Ndërkombëtarizimi. Fakulteti ka vetëm ri marrëveshje të bashkëpunimit me dy programe turke Master dhe të PhD-së, dhe një tjetër me Shqipërinë. Universiteti është duke negociuar me dy universitete të SHBA-ë për shkëmbimin e studentëve dhe profesorëve, dhe është afër arritjes së një kontrate Erasmus me Universitetin e Athinës në Greqi.

Pasi që është një fakultet i ri, tani është e mundshme që të hartohet një plan strategjik i cili përfshinë aktivitetet te fortë ndërkombëtarë. Fakulteti ka nevojë që të zhvillojë një strategji të aktë dhe reale për ndërkombëtarizimin e aktiviteteve të tyre, projekteve dhe programe të tij. Gjithashtu profesorët dhe studentët duhet të bashkëpunojnë në këtë strategji.

Nëse Fakulteti dëshiron që të tërheq staf akademik ng jashtë Kosova, është e nevojshme që të zhvillohet një strategji për të arritur këtë objektiv.

Financat, Infrastruktura dhe Hapësirat

Universiteti ka një ndërtesë dhe prandaj Shkolla vetëm aty mund të vendosej. Hapësirat nuk janë adekuate, nuk ka klasa të vogla për takime apo seminare për studentët, nuk ka hapësirë për bibliotekën e Fakultetit, nuk ka qasje në faqet e internetit, databazat, reportarët bibliografik, etj. Prandaj Universiteti duhet të bëjë përpjekje të madhe për të siguruar mjetet për të siguruar mësimdhënie cilësore.

Fakulteti Juridik nuk ka një buxhet të ndarë. Gjitha paratë të cilat pranohen, menaxhohen nga Universiteti në buxhetin e përgjithshëm të tij. Një objektiv primar është arritja e pavarësisë ekonomike dhe

tërheqja e më shumë burimeve nga institucionet private dhe publike. Në mënyrë që të zhvillohen projektet e tyre hulumtuese dhe planet e përmirësimit. Mësimdhënia, hulumtimi dhe zhvillimi i studentëve përmirëson edhe cilësinë nëse ka më tepër burime në dispozicion. Vite më nëse shikohet në pavarësinë ekonomike atëherë mund të zhvillohet dhe të zgjerohen planet mësimdhënëse të fakultetit dhe të ofrohen lëndë të specializuara.

Menaxhimi i Cilësisë

Raporti i vet vlerësimit, i cili përmban gabime të ndryshme e të cilat janë sqaruar në takime, nuk flet asgjë për qeverisjen e Fakultetit. Ka koordinim të përgjithshëm mirëpo asgjë më shumë. Kjo është pasi që Fakulteti Juridik i UGJ-së ka vetëm një program: të tjerat janë ende degë të Universitetit të Prishtinës. Prandaj, vlerësimi i organizimit është virtualisht i pamundshëm. Nëse shumica e profesorëve të vitit të parë janë pjesë të Universitetit të Prishtinës, atëherë Fakulteti Juridik do të ketë problem.

Sipas Universitetit, Fakulteti ka pyetësorë të cilët i përdor për të vlerësuar në baza vjetore profesorë dhe fakultetin. Studentët duhet të plotësojnë pyetësorët. Gjatë bisedës me ta ata thanë se shumica e studentëve nuk e plotësojnë pyetësorin dhe prandaj vlerësimi i profesorëve dhe fakultetit bëhet vetëm për grupe të vogla të studentëve. Ndoshta fakulteti duhet të rimendojë se si të merr përgjigjet nga studentët. Një pyetësorë online i cili garanton anonimitetin e studentëve do të ishte një zgjidhje e përshtatshme, mirëpo mund të përdoren edhe masa të tjera si psh studentët të mos mund të i shohin rezultatet e provimeve deri sa të mos plotësojnë dhe kthejnë pyetësorët. Në këtë mënyrë mund të merren informacionet për cilësinë e profesorëve dhe për edukimin që ofrohen në SHKollë.

Në fund, institucioni ka një procedurë për vlerësimin e studentëve i cili kombinon provimet me shkrim dhe punën personale të studentëve. Nuk ka asnjë dokument i cili përmban apo përshkruan një procedurë të tillë për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin.

Rekomandime:

- Pozicionimi i programit duhet të jetë i qartë: a është program i bazuar në teori apo ka për qëllim që të oforjë edhe një pjesë të rëndësishme praktike?
- Duhet të ketë praktika në institucione.
- Brenda një viti duhet të krijohet Dekani, me ekipin e tij dhe me Këshillin e Fakultetit dhe së paku dy departamenti një për të Drejtën Private dhe një për të Drejtën Publike.
- Fakulteti duhet që për çdo vit të shpallë konkure për profesorë të rinj deri sa të plotësohen gjitha Indet me staf akademik;
- Fakulteti Juridik duhet të prezantojë një program të formalizuar të zhvillimit profesional dhe i cili mbështet stafin akademik gjatë gjithë procesit të tyre të mësimdënies;
- Gjithë profesorët (ordinarë, asistentët dhe profesrët e asocuar) duhet të kenë planet e tyre për hulumtim personal apo projekte për hulumtim, të cilat rishikohen në baza të rregullta dhe vlerësohen nga Fakulteti Juridik;
- Në përpuhje me rekomandimet e mëhershme, duhet të krijohet zyra e Pro Rektorit për hulumtim, sa më shpejtë që të jetë e mundur brenda Fakulteti Juridik;
- Është e nevojshme që Fakulteti të ketë bibliotekë;
- Fakulteti Juridik duhet që me urgjencë të përgatisë një Plan Strategjik të Zhvillimit i cili duhet të përmbajë qëllime të përkufizuara, reale dhe të realizueshme dhe të matshme në baza vjetore. Gjithahstu departamentet duhet të prodhojnë plane të ngjashme për fushat e tyre të aktivitetit, të cilat përshtaten me planin e përgjithshëm të Fakultetit;
- Fakulteti duhet të ndrysojë mënyrën se si i merr pyetësorët nga studentët;
- Fakulteti duhet të elaborojë një dokument i cili duhet të përmbajë kritere për zhvillimin e cilësisë;
- Fakulteti duhet të zhçillojë një dokument i cili përshkruan strategjinë për ndërkombëtarzim;
- Ndërkombëtarzimi është një çështje e cila duhet të udhëhiqet nga Dekani i Fakultetit;
- Institucioni duhet të konsideroj futjen e temës së bachelorit apo raktikës në kurrikulën e programit;
- Duhet të konsideroj futjen e lëndëve në kurrikulë për teknologjitë e reja, denotologjinë apo bietikën;
- Fakulteti nuk duhet të propozojë programe apo tituj të ri derisa të ketë përfunduar zhvillimin e programit Bachelor në Juridik.

Propozimi për akreditim

EE propozon akreditimin për një vit të programit bachelor në Juridik të Fakultetit Juridik.

UGJ duhet që për një vit të zgjidhë pikat kritike si:

- Krijimin e një biblioteke specifike për juridik, për punë kërkimore dhe për studentët e cila duhet të pajisjet me libra dhe me materiale të tjera.
- Të përkufizojë një plan strategjik për ndërkombëtarizimin e Fakultetit sa i përket shkëmbimit të profesorëve dhe studentëve;
- Të krijojë tri grupë të hulumtimi të projekte specifike dhe me rezultate të cilat mund të vlerësohen.
- Të hartohet dhe të miratohet një dokument i cili përcakton aspektet esenciale të Menaxhimit të Cilësisë.
- Të arrihet ndarja e buxhetit për Fakultetin Juridik.

3.2. Fakulteti Ekonomik (vlerësuar nga Prof.Dr.MihaSkerlavaj)

3.2.1. Banka, Financa dhe Kontabilitet (BSc) – RI – AKREDITIM I PROGRAMIT

BSC në Banka, Financa dhe Kontabilitet (tutje i referuar si BAF) është një program 3 vjecar i cili është zhvilluar nën obrellën e Universiteti të Prishrinës (UP) dhe aktualisht ofrohet si program 1 vjecar në UGJ dhe program 2 vjecar dhe 3 jecar në UP në Gjilan. EE mendon se përgjithësisht struktura e programit është e arsyeshme, caktimi i ECTS-ve është i përshtatshëm dhe stafi është i kualifikuar për lijeruar. Megjithatë, EE kupton se shumica e stafit është i angazhuar me gjysmë norme në UGJ dhe shumica e tyre ligjërojnë në UP apo në disa institucione të tjera të arsimit të lartë, shumica në Prishtinë.

Për më tepër sfida e programit BAF (si dhe e insitucionit) do të jetë tërheqja e stafit akademik full time. Duket se menaxhmenti i UGJ-së mund të merr staf nga profesorët lokal të cilët veqse janë të kualifikuar me tituj akademik e të cilët aktualisht punëojnë në Prishtinë, praktikues të cilët janë të gatshëm të hyjnë në botën e respektuar të akademikë në Kosovë apo nga persona shqiptarë të kualifikuar jashtë Kosovës. Posacërishr në dy rastet e mëvonshme, EE parasheh se institucioni duhet të bëjë përpjkeje tepër të moda për të qenë i sukseshsëm në qëllimet e tij për të angazhuar staf akademik të cilët janë kompetent të nivelit të lartë.

Rekomandim: UGJ ka nevojë që të tërhek (dhe të zhvillojë) staf akademik full time në mënyrë që të ofrojë programin BAF në UGJ në baza afat gjata dhe të kontribojë në aktivitetin hulumtues në Gjilan.

EE dëshiron të theksojë se ka pak paqartësi në kuptim të titujve aktual akademik të cilët jepen me rastin e përudnimit të programit. Në pjesët e para raporti i vet vlerësimit i referohet programit si BA, përderisa në faqen 167 të raportit të vlet vlerësimit programi është përshkruar si BSc. EE ka mësuar përmes bisedave me koordinatoren e programit se programi është BSc.

Në kuptim të strukturës ë programit, EE mendon se programi përgjithësisht është konsistent. Megjithatë ka disa mundësi për përmirësime në strukturën e programit. Për shembull, nuk ka asnjë arsye për të emërtuar lëndën Mikroekonomi I, pasi që programi nuk ofron Mikroekonomi II.

Rekomandim: Mikroekonomia I duhet të emërohet vetëm Mikroekonomi.

Etika në kontabilitet dhe auditim sa i përket përmbajtjes duke se përgjithësisht është një lëndë për eikën biznesore. EE ka rekomanduar përgjegjësin e programit që të zhillojë (dhe të emërtojë) lëndën në dretim të etikës së biznesit aplikativ dhe të konsideroj ofrimin e lëndës s lëndë obligative. Ky është një trend në shumicën e shkollave lidere të biznesit në botë dhe është një përpjekje për të arsimuar më mirë gjeneratat e ardhshme që të reflektojnë dhe të vperojnë në mënyrë etike kur të ketë dilema.

Rekoamndime: Etika në kontabilitet dhe auditim duhet të riemërohet dhe të zhvillohet në drejtim të etikës së biznesit të aplikuar dhe të ofrohet si lëndë obligative.

Literatura në syllabuset e lëndëve është mjaft e vjetër (duke filluar nga 1995 – 2003, me përjashtime të rralla të vitit 2007) dhe është e kufizuar nga aftësitë e milituara të gjithës angleze të studentëve dhe nga përkthimet e dobëta në gjuhën angleze. Si pjesë e misionit të UGJ-së është arsimimi i studentëve që të jenë në gjendje të punojnë në tregje ndërkombëtare, EE sugjeron UGJ-në që të zhvillojë aftësitë gjuhësore të studentëve si pjesë integruese dhe pjesë obligative e procesit.

Rekomandim: UGJ duhet që sistematikisht të zhvillojë aftësitë gjuhësore të studentëve në gjuhën angleze duke a) krijojë një rregull që së pau një ligjëratë për njëlëndë të ligjërohet në gjuhën angleze (p.sh. nëse ftohen ligëruet të huaj dhe përsëri kjo të jetë pjeë e provimit) dhe/ apo të jetë një lëndë obligtaive në secilin smeestër e cila ligjërohet ploëtsisht në gjuhën angleze.

Bazuar në listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe bisedave me studentët me me bordin menaxhues, EE dëhsiron të augjerojë që të thellohen lidhjet në mes të UGJ-së, studentëve dhe punëdhënësve potencial. EE mirëpret gjitha përpjekjet aktuale të UGJ-së dëshron që të rekomandojë përgjegjsinë e programit dhemenaxhmentin e UGJ-së që të fuqizojnë aktivitetet tyre drejt zgjerimit të mudnësive për praktika.

REKOMANDIM I PËRGJITHSHËM: Programi BSc Banka, Financa dhe Kontabilitet mund të ri-akreitohet. UGJ duhet të kushtojë vëmendje në implementimin e rekomandimeve specifike të dhëna nga EE.

3.2.2. Marketing (BSc) – RI-AKREDITIM

BSc përballet me problemet dhe sfiat e njëjta sikurse programi BSc në Banka, Financa dhe Kontabilitet. Për më tepër, ka edhe disa çështje shtesë të tjera të cilay janë përkshkruar më poshtë.

Rekomandim: EE inkurajon GJ-në që të zbatojë rekomandimet e dhëna për programin BAF gjithashtu edhe për programin Marketing BSc. Posacrisht, sa i përket angazhimit të stafit full time në program, zhvillimin e aftësive të gjuhës angleze dhe ofrimi i më tepër mundësive për praktika për studentë.

Përpos kësaj, sipas mendimit të EE, programi Marketing mund të përfitojë tepër nga ristrukturimi i kurrikulës në mes të asaj se cfarë ofrohet si lëndë zgjedhore he cfarë si lëndë obligative. Idea e përgjithsme është që programi bachelor i specialuzar në marketing të i ekspozohet në një shkallë më të lartë lëndëve të specializuara në marketing sesa p.sh. ekonomia e përgjithshme apo lëndët elidhura me financat.

Rekomandime: EE propozon që lëndët E-Marketingu, Marketingu Industrial dhe Marketingu i SHërbimeve të jenë lëndë obligative. Në ven të kësaj lëndët si Vendimmarrja dhe lëndët e tjera të cilat nuk janë specifike për marketing të jenë lëndë zgjedhore.

REKOMANDIMI I PËRGJITHSHËM: Programi BSC Marketing mund të ri-akrefitohet. UGJ duhet ti ushtojë vëmndje implementimit të rekomandimeve specifike të dhëna nga EE.

3.2.3. Administrim Biznesi (MBA) – PROGRAM I RI PËR AKREDITIM

UGJ ka aplikuar me një program një vjecar MBA në administrim Biznesi i cili është marrë në konsiderim nga AAK dhe EE. Pas leximit me kujdes të raportit të vet vlerësimit dhe pas diskutimeve me përgjegjës të programit, EE arrin në përfundimin se programi vuan nga disa çështje shumë serioze dhe të pazgjidhura.

Së pari, nuk është i qartë se cili do të jetë profili i studentëve. A është një program i cili ka për qëllim që të arsimojë analistët biznesor apo për persona të cilët janë arsimuar më parë në fusha të cilat nuk lidhen me biznesin? Kjo është dilema që ka ndikim jetik në strukturën e programit, përmbajtjen e lëndëve dhe ofrimin e tij.

Rekomandim: UGJ duhet të analizojë nevojat e studentëve dhe organizatave në komunitetin lokal për të zhvilluar në të ardhmen një program master në fushën e biznesit.

Së dyti, asnjë nga stafi akademik nuk ka përvojë në mësimdhënie në programe MBA. Duke pasur parasysh specifikat e tij, EE fton UGJ që të marrë shembuj dhe të përfitojë nga programet Tempus, nga mobiliteti i profesorëve përmes Erasmus dhe nga format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtarë për të zhvilluar programe të nivelit master. Përpos kësaj, kërkesat për të bërë një gjë të tillë kërkon edhe aktivitet të hulumtimit në nivelin institucional. Pasi që ky proces merr kohë, EE rekomandon UGJ-në që të veprojë në mënyrë strategjike dhe të orijtojë infrastrukturën e nevojshme dhe mbështetjen në hulumtimet relevante të cilat janë të lidhura me misionin e UGJ-së dhe të cilat i shërbejnë ambientit lokal.

Rekomandim: EE i bën thirrje urgjente UGJ-ë që të veprojë në drejtim të tërheqjes së stafit akademik të kualifikuar, dh të ofrojë atyre mundësi që të bëjnë punë kërkimore relevante dhe të përfitojnë nga

mundësitë e bashkëpunimit në fuqizimin e kompetencave të stafit dhe implementimin e çdo lloji niveli master i cili lidhet me fushën e biznesit.

Së trej, programi i sugjeruar MBA nuk është në përputhje me kategorizimin e KKK. Zakonisht, programet e tilla përfundojnë me një punim master në mënyrë që studentët të marrin shkalën MA/ MSc.

Së katërti, EE nuk ka qenë i kënaqur me përgjigjet e marra, nga takimet dhe nga RVV, se si programi i studimit ndryshon nga ndonjë program MSc. Në vend të kësaj, RVV syjgeron që programi MBA duhet të aftësojë të diplomuarit nga programet ekzistuese BSc që ata të zhvillojnë njohuri hulumtimi të cilat lidhen e fushën biznesore. Argumentimi shtesë i ofruar ishte se ky program të i ofron studentëve me njohuri të avancuara. Kjo ishte përgjigja e njejtë që ekspertët kanë marrë kur është shtruar pyetja lidhur me dyfishimin në mes të lëndëve identike në programin BSc dhe nivelin master. Mbi të gjitha, EE mendon se ka mangësi sa i përket zhvillimeve të niveleve të larta të të mësuarit në përputhje me taksonominë e Bloom. Programet MBA në gjithë botën varen tepër shumë nga mësimi eksperimental i cili ka për qëllim që të zhvillojë aftësi dhe qasjet e studentëve.

Së pesti, programi ekzistues, lidhshipi, sjellja organizative, dhe menaxhimi i burimeve njerëzre, aftëitë dhe qasjet janë gjitha të shkruara në lëndën për menaxhimin e njerëzve. Kjo është absolutisht jo adekuate dhe e pamjaftueshme. Në vend të kësaj ka dia lëndë të cilat janë më të përshtatshme për nivele master të specializuara në financa se sa për një program MBA.

REKOMANDIM I PËRGJITHSHËM: Programi i sugjeruar MBA në Administrim Biznesi nuk mund të akreditohet. EE fton UGJ-në që të analizojë me qarësi nëvoat arsimore dhe partnerët ndërkombëtarë gjatë hartimit të çdo programi në nivelin master.

* Pas draft raportit, menaxhmenti i institucionit ka komentuar se Universiteti Kadri Zeka ka vendosur që *"profili i studentëve të jetë i kombinuar dhe të përfshijë studentët me përvojë paraprake so dhe udhëheqës të arsimuar në fusha ndrysh prej biznesit. Megjithatë, tragei primar do të jetë kategoria e parë. Gjithashtu pasi që ky progra akademik nuk është komaptibil me kategorizimin e KKK ashtu sic ekspertët e kanë përmendur. Menaxhmenti i Universitetit dëshron që*

të vazhdojë me një program MSc në Administrim Biznesi". EE pranon se ky është një ndryshim i madh i cili kërkon një round të ndarë të akreditimit dhe para saj kjo kërkon edhe hartim të kujdesshëm të programit bazuar në pikat e reja të përemdnura.

3.2.4. Menaxhment dhe Informatikë (BSc) (vlerësimi nga Prof.Dr. Eduardo Vendrell Vidal) – AKREDITIM

Programi i studimit Menaxhment dhe Informatikë ndjek dhe ka trashëguar strukturën dhe përmbajtjen e njëjtë nga programet e tjera të studimit të cilat janë krijuar në Fakultetin Ekonomik si degë të Universitetit të Prishtinës.

Përshtupja e përgjithsme e gradës akademike është e mirë, në kuptimin se vazhdon me një program të mirë njohur të studimeve, i cili si fokus të qartë ka trajnimin e studentëve të institucioneve publike apo private të menaxhmentit dhe të organizatave, shumica nga këndvëstrimi ekonomi. Aspekti "Informatikë" nuk është aq relevant në programin e studimit, përpos përkufizimit të thjeshtë të titullit të programit. Është konfirmuar se tradicionalisht emrat e gradave të tilla akademik përfshijnë informatikën" mirëpo përmbajtja e programeve më së shumti lidhet me aspektet e menaxhimit.

Tjetër, disa aspekte janë përshkruar në mënyrë të detajuar në mënyrë që programi të mund të vlerësohet ashtu sic duhet.

Programi akademik

Programi i studimeve duket se është mirë i strukturuar dhe se është i njohur nga studentët Ndjek qasjen e njëjtë të ish programit të studimeve në Menaxhment dhe Informatikë dhe se fokusohet më shumë në Menaxhment. Lëndët e lidhura me informatikën janë zbehur në vitet e fundit, dhe se tani kanë mbetur vetëm disa referenca për përdorimin e TI-së nëpër organizata. Përmbajtjet e këtyre lëndëve "Informatike" janë më së shumti të lidhura me përdorimin e disa nga

mjeteve më të njohura për qëllime të menaxhmentit. Në këtë aspekt, mungesa e mjeteve të vërteta të Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes është vërejtur nga ekspertët.

Një grumbull i kompetencave të përgjithshme dhe teknike duhet të përfshihen si udhëzuesit kryesor të programit, në mënyrë që të definohet më tepër dhe të lidhen rezultatet e të mësuarit në të gjitha lëndët.

Referencat e jashtme.

Programi ka trashëguar dhe vazhdon me përmbajtjet e njëjtja sikurse grada akademike Menaxhment dhe Informatikë në Universitetin e Prishtinës, dhe se ka referenca të jashtme endërkombëtare disa programe të studimit (banka, financa dhe kontabilitet; marketing; ekonomiks) të Universitetit të Lubjanës dhe Universitetit të Zagrebit.

Struktura e programit.

Grada akademik është strukturuar si një program tre vjeçar, secili me 60 kredi. Balancimi në mes të kredive teorike dhe praktike duket se është bërë mirë, si dhe balancimi në mes të lëndëve obligative dhe atyre zgjedhore.

Sipas përshkrimit të programit, studentët duhet të angazhohen në praktike; do të caktohen kredi për përvojën e punës në ambiente jo shkollore. Fakulteti i jep rëndësi praktikave dhe kredive për to, dhe ka caktua një marrëveshje me një këshill biznesor në Gjilan për mbajtjen e praktikave të studentëve aty gjatë semestrit veror. Ky është një aspekt i rëndësishëm i cili i jep vlerë programit si dhe procesit të mësimdhënies të studentëve Mirëpo sipas përkufizimit dhe strukturës së programit nuk është e mundur të bëhet identifikimi se nëse praktika konsiderohet si pjesë e lëndëve apo njihet si një lëndë më vete. Në këtë rast, nëse praktika ka vlerë në kredi, studentët do të marrin më shumë se 60 ECTS në vitin e tretë. Ky aspekt udhet të sqarohet në programin e studimit.

Mësimdhënia dhe vlerësimi.

Gjitha lëndët e përfshira në program kanë përshkrim të gjerë dhe të përgjithshëm, mjaft të ngjashëm me njëra tjetrën, edhe sa i përket metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit. Gjithashtu rezultatet e të mësuarit janë përshkruar si një listë e përmabjatjeve dhe njohurive, dhe nuk lidhen me kompetencat.

Duket se në të ardhmen e afërt, duhet të zhvillohet një platformë e mësimit e cila bazohet në sistemin Moodle, dhe që duhet të përfshijë informacione për lëndët dhe detjate e mësimdhënies dhe mësimmarrjes. Për momentin, informacione për secilën lëndë janë dhënë në një formë të lirë.

Nuk ka rregullore të përgjithshme apo rekomandime sa i përket metodologjisë së mësimdhënies. Universiteti nuk posedon një zyrë për menaxhimin e mësimdhënies e cila do të mund të asistojë ligjëruesve në këtë aspekt.

Stafi

Për momentin, Programi Menaxhmen dhe Onformatikë ka staf i cili përbëhet nga 24 ligjërues, të cilët shumica janë të lidhur me Universitetin e Prishtinës. Një nga sfidat më të mëdha të Fakultetit do të jetë rekrutimi i stafit full time i cili do të merret me punët akademike. Më shumë staff do të sigurojnë stabilitetin akademik si dhe ligjërues më të anahzuar për temat të cilat lidhen me programin e studimit.

Hulumtimi

Në secilin universitet, është e rëndësishme që të sigurohen aktivtete të hulumtimit të cilat janë të lidhura afër me temat e mësimdhënies, e të cilat sigurojnë përgjigje dhe rezultate të aktualizuara të mësimit. Kjo është përgjithësisht një sfidë e cila është prezente në zhvillimin akademik.

Në raportin e vet vlerësimit, nuk ka asnjë dëshmi në lidhje me ndonjë plan të hulumtimit për programin e studimit.

Stafi permanent i organizuar në grupe të hulumtimit zakonisht kryen aktivitete të hulumtimit. Si rezultat i takimit me ligjëruesit, është parë një përkushtim i përgjithshëm nga stafi akademik. Në të njetën kohë, fillimi i aktiviteteve të hulumtimiti përmes grupeve të organizuara të hulumtimit mbetet vetëm një dëshirë e përbahskët e ligjëruesve. Kjo mudësi është e lidhur në mënyrë të qartë me stafin permanent dhe me një buxhet dhe hapësira stabile. Dyja aspektet duhet të rishikohen kur të fillojnë punën grupet e hulumtimit.

Bashkëpunimi Ndërkombëtarë.

Një aspekt i rëndësishëm për universitetin është arritja e bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. UGJ është një universitet i ri dhe një nga qëllimet e tij, ashtu sic është shprehur në pkanin e tij strategjik për të arritur misionin e tij, është rritja e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve nga shtetet e tjera.

Në përshkrimin e programit të studimit, duket se nuk ka ndonjë strategji konkrete për ndërkombëtarizimi, përpos atij të shprehur nga universiteti.

Financat dhe Infrastruktura.

Ashtu sic është thënë në takimin me ligjëruesit dhe koordinatorët e programit, për momentin buxheti i ndarë për këtë program nuk është i lartë. Duket se Ministria e Arsimit duhet të jap më tepër mbështetje akademik në të ardhmen e afërt.

Gjatë vizitës së haësirave të fakultetit, janë evidentuar disa mangësi: nuk ka libra të mjaftueshëm në bibliotekën e universitetit, shumica e tyre janë vetëm seri të leximit; duket se nuk ka qasje të lirë të internetit në sallat e studentëve; ka mungesë të laboratorëve të dedikuar për kompjuterë.

Këto aspekte duhet të adresohen sa më shpejtë që të jetë e mundur në mënyrë që të sigurohet një shkallë minimale e stabilitetit dhe cilësisë së programit të studimit.

Menaxhimi i cilësisë

Universiteti ka një procedurë të përgjithshme të menaxhimit të cilësisë e cila dërron nga niveli i universitetit dhe i cili bazohet në raportet finale të cilat i dedikohen follderit të secilit ligjërues. Përpos kësaj, nuk k ndonj kërkesë specifike apo aktivitete të planifikuara për sigurimin e cilësisë.

Fakulteti ka siguruar se secila lëndë e programit është vlerësuar.

Në mënyrë që të garantohet një proces korrekt i sigurimit të cilësisë, Fakulteti duhet të fillojë me një procedurë të brendshme të mbledhjes së opinionëve nga studentët dhe ligjëruesit për aspekte të ndryshme akademike (rezultatet e të mësuarit: si ato transmetohen dhe si arrihen, vlerësimi, ngarkesa e studentëve...).

Rekomandime

- Tema kryesore e programit të studimit duhet të sqarohet, pasi që fjala "informatike" në titullin e programit nuk është se është e vërtetë. Korigjimi i emrit duhet të bëhet në mënyrë që të transmetohet edhe programi i skatë.
- Menaxhmenti dihet të përfshijë zgjidhje dhe qaje të TI-s në programin e studimit.
- Të përkufizohet se si prkatkat janë të përfhsira në kurrikulë, duke i dhënë mudnësinë studentëve që të dijnë se si të arrijnë dhe ti njohin këto aktivitete.
- Të përkufiozhet një set i kompetencave të përgjithshme dhe kompetencave teknike specifike për programin, në mënyrë që rezultate e të mësuarit mund të derivojnë dhe të caktohen për secilën lëndë.
- Të përkufiozhen aktivitete specifike të mësimdhënies dhe vlerësimit për secilën lëndë, të cilat lidhen me rezultatet e të mësuarit. Të ofrohet një platformë ku studentët dhe profesorët do t mund të ndajnë dhe monitoronë aktivitetet akademike.
- Të sigurohet se stafi permanent është i angazhuar për programin e studimit në mënyrë që aktivitetet e hulumtimit dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë të mund të organizohet.
- Të hartohet një plan real në mënyrë që t ë merren fonde dhe urime në mënyrë që programi i studimeve të jetë stabil.
- Të hartohen procedurat bazike për menaxhimin e cilësisë, me anë e pyetsorëve për profesorët dhe studentët, në mënyrë që

të meret opinioni për aspekte akademike. Orcedura bazë duhet të cojë në përmirësimin e organizimit të mësimdhënies dhe mësimarrjes.

Propozimi për akreditim

Eksperti propozon akreditimin me kusht të programit BSC në Menaxhment dhe Informatikë të organizuar nga Fakulteti Ekonomik.

Fakulteti duhet të bëjë zgjidhjen e pikave kritike si në vijim:

- Përkufizimin e temave reale të programit.
- Përkufizimin e kompetencave dhe rezultateve të mësimit për programin e studimit.
- Përkufizimin e kurrikulës për periudhën e praktikave të studentëve, të cilat njihen dhe pranohen nga studentët.
- Organizimi dhe përmirësimi i gapësirave në mënyrë që ato të pranohen nga studentët. Të fillohet me një laboratorë të kompjuterëve për ligjëratat praktike të zgjidhjeve të TI-së në menaxhment. Grupet e ardhshme të hulumtimit mund të punojnë në këtë laborator.
- Të definohet një plan strategjik për ndërkombëtarizim.
- Të krijohen minimum dy grupe të hulumtimit me tema specifike dhe iniciativa të cilat mund të vlerësohen.
- Të arrihet ndarja e buxhetit për fakultetin.
- Të fillohet me hartimin e një rregulloreje bazë për Menaxhimin e Cilësisë.

3.3. Fakulteti i SHkencave Politike

3.3.1. Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci (MND) AKREDITIM (vlerësuar nga Prof.Dr. Norbert Kapferer)

Vlerësimi

Fakulteti i Shkencave Politike nuk ka ekzistuar deri më tani. Ka plane që të themelohet një Institucion i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë nga vjeshta 2014 e tutje. Për të shmangur keqkuptimet duhet të dijmë që Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomacia janë pjesë e Shkencës Politike, specializime në fushën e Shkencave Politike përpos Teorisë Politike, Historisë Politike, Sistemeve Politike, Punëve të Brendshme, Ekonomisë Politike dhe Sociologjisë Politike, Drjëtësisë dhe Politikës etj. Programi i studimit nën vlerësim quhet: Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, i cili përdshin lëndë si Hyrje në fushat e specializimeve të Shkencave politike të përmendura më sipër të cilat janë të nevojshme për njohuritë bazike. Mirëpo programi nuk fokusohet në marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci. Kjo është e paqartë sepse grada akademike (bachelor) titullohet "Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci" dhe jo Bachelor në Shkenca Politike.

Programi Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare (MND) është një program i ri i cili do të ofohte nga Vjeshta 2014 nga një institucion i cili do të quhet "Instituti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë" dhe jo nga "Fakulteti i SHkencave Politike" sepse kjo është keqkuptues.

Kohëzgjatja minimale e studimeve është llogaritur të jetë 3 jet (apo gjashtë semestra) që është standard i programeve Bachelor, mirëpo caktimi i ECTS-ve (180 ECTS (4x 60 ECTS) nuk është shumë i qartë dhe transparent.

Programi i studimit i përbërë nga 6 semestra, ashtu sic është thënë në Raportin e Vet Vlerësimit nuk mund të gjykohet plotësisht sepse vetëm 3 semestrat e parë janë përshkruar në gjuhën angleze. Pjesa anglisht e programi absolutisht nuk është organizuar mirë. Është e mbingarkuar dhe disa nga lëndë janë të tepërta. Unë nuk mund të identifikoj asnjë logjikë sistematike sa i përket studimeve në teori dhe praktikë për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Nuk ka

karahseshmëri ndërkombëtare në nivelin e Universiteteve Evropiane në këtë program. Vetëm lëndët për gjuhët janë të dobishme dhe duket se janë të respektueshme.

Përshkrimi i ëndëve është pjesërisht prapa standardeve shkencore. Prandaj unë kam dyshimet e mia se personi përgjegjës për këtë program të studimit është i kualifikuar për këtë detyrë. Nëse personeli i planifikuar shkencorë prej 19 ligjëruesve me dragën Dr. Sc, do të jetë më imirë, kjo është një pyetje e hapur. Mirëpo gjithashtu e paqartë se stafi akademik a është i angazhuar me kontaktë të plotë apo është i ajshëm.

Iniciativat për hulumtim kryhen zakonisht nga stafi i përhershëm dhe se është i lidhur afër me temat që ata ligjërojnë, mirëpo në raportin e vet vlerësimit mungon një plan bazikë për punën kërkimore për programin e studimit. Gjatë takimeve me stafin (e jashtëm) u bë e qartë se nuk ka asnjë ide konkrete për aktivitete të hulumtimit.

Në përshkrimin e programit, mungon ndonjë strategji e vecantë për ndërkombëtarizimin, për mobilitetin e stafit akademikd eh studentëve nga shtete e tjera si dhe nuk ka asnjë pan për bashkëpunim apo marrëveshje ndërkombëtare.

Rekomandime:

- Duhet të sqarohet 1. Cfarë lloji i fakultetit/ institucionit duhet të themelohet, Fakulteti i SHencave Potiike apo i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë; 2. Cfarë grade akademik do të ofrohet: Bahcelor në Shkenca Poltiike apo Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe diplomaci; rekoamdnimi im është që të krijohet një institucion i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Iplomacise i cili do të ofrojë studime me 6 semestra, dhe i cili përfudnon me marrjen e gradës Bachelor. Pasi te praktikohet me sukses për disa vite, pastaj institucioni mund të zgjerohet në Fakultet të Shkencave Poltiike;
- Programi i studimit duhet të riorganizohet, në mënyrë që të korrespondojë me identitetin e Fakultetit/ institucionit. Në

rast të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë, programi i studimit udhet të fokusohet në atë çështje dhe të ofrojë qasje sistematike përkra studimeve cilësoe në teori dhe praktikë. Për secilën lëndë specifike aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimarrjes duhet të definohen, dhe të lidhen me rezultatete e të mësuarit. Duhet të ketë një platformë përmes së cilës ligjëruesit dhe studentët mund të ndajnë dhe të monitorjnë aktivitetet akademike.

- Duhet të ketë një staf të kualifikuar dhe permanent i cili është i përkushtuar për programin e studimit që të shërbejë si parakusht për aktivitete të hulumtimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtarë.
- Fakulteti i ri duhet të gjejë mbështetje ndërkombëtare dhe të merr këshilla nga universitetet me përvojë Evropiane duke i ftuar ligjërues me përvojë si profesorë vizitorë.

Porpozimi për akreditim

Personat përgjegjës për Fakultetin/ Institucionin e ri duhet të zgjedhin pikat kritike si në vijim:

- Përkufizimin e identitetit shkencor të institucionit (Fakulteti i Shkencave politike apo Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë).
- Sipas kësaj, përkufizimin e gradës së saktë akademike.
- Riorganizimin e programit të studimit, korrespondimin me identitetin e Fakultetit; programi i studimit duhet të korrespondojë më standardet ndërkombëtare dhe të ofrojë një qasje shkencore;
- Duhet të angazhohet staf permanent dhe i kualifikuar në mënyrë që të garantohet nivel i lartë i edukimit, hulumtimit dhe reputacionit ndërkombëtarë.
- Përkufizimi i planeve strategjike për ndërkombëtarizimin e fakulteti të ri përmes shkëmbimit të profesorëve dhe studentëve.

3.4. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike (vlerësuar nga Prof.Dr. Eduardo Vendrell Vidal)

3.4.1. Shkenca Kompjuterike (BA) –PROGRAM I RI NË AKREDITIM

Programi Bachelor në Shkenca Kompjuterike është një program i ri i cili është hartuar nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike për Vjeshtën 2014. Programi studimit është mirë i organizuar dhe përmbajtjet janë të përkufizuata përmes një seti të lëndëve obligative, përfshirë parimet bazë të Shkencave Kompjuterike, dhe dy specializimeve të ndryshme: Inxhinieri Softueri dhe Dizajn i Ueb-it, dhe Informatikë në Ekonomi.

Përshlytja e ërgjithsme është që programi është i mirë, dhe përfshinë qasje reale sa i përket përmbajtjeve në Shkencave Kompjuterike, të krahasueshme për programet e studimit të kësaj ushë përgjatë Evropës.

Së dyti, disa aspekte janë dhënë në formë të detajuar për të dhënë një vlerësim të përshtatshëm të programit të studimit.

Programi akademik

Programi studimit është i strukturuar mirë. Lëndë bazë të zakonshme të SHK janë përfshirë në dy vitet e para ndërsa viti i tretë i dedikohet specializimit, përfshirë projektin specifik për punimin final të diplomës.

Një set i kompetencave të përgjithshme dhe teknike duhet të përfshihen si udhëzues kryesor të programit, në mënyrë që të përkufiozhen tutje rezultatet e mësimit dhe të zhvillohet në të gjitha lëndët.

Referencat e jashtme

Përmbajtjet dhe qëllimet e programit janë reflektuar mirë dhe janë harmonizuar me programet e jashtme të studimit (Kingston University, Vienna University of Technology, Johannes Kepler University in Linz, Imperial College London, Munich University of Technology, dhe disa Kolegje në Kosovë).

Sido që të jetë, mungesa e krahasimeve me programe të tjera të mirë njohura është vërejtur. Në këtë aspekt, "Kurrikula për

Kompjuterë" ACM/ IEE apo kompetencat e bazuara në EURO INF duhet të përdoren si referenca për programin.

Struktura e programit

Grada akademike është strukturuar në një listë të lëndëve të cilat janë shpërndarë në mënyrë unifromë në të trija vitete e studimit, 60 ETCS për secilin vit. Balancimi në mes të kredive teorikë dhe praktike duket se është shpërndarë mirë, si dhe lëndët e specializuara dhe lëndët obligative e zgjedhore.

Ka disa marrëveshje verbale dhe formale me disa nga kompanitë lokale për të ofruar praktika për studentët. Kjo praktikë nuk është e përkufizuar mirë në programin e studimit: kur e fillojnë praktikën studentët? A është e prnaur me kredi?

Mësimdhënia dhe vlerësimi

Gjitha lëndët e përfshira në program kanë një përshkrim specifik në kupim të mësimdhënies dhe ngarkesës dhe metodave të vlerësimit. Gjithashtu përmbajtet dhe rezultatet e mësimin jnaë përfhirë, megjithatë ato nuk janë të lidhura me kompetencat.

Duket se në ardhmen e afërt, duhet të zhvillohet një platformë e mësimin Moodle e cila përfshinë informacione për lëndët dhe mësimdhënien/ mësimin marrjen në detaje. Për momentin, informacionet e dhëna për secilën lëndë janë ofruar në një formë të lirë.

Nuk ka rregullore të përgjithshme dhe as ekomandime për metodologjitë e reja në mësimdhënien. Universiteti nukka një zyre për menaxhimin e mësimin e cila do të mund ti asistonte ligjëruesve në këtë aspekt.

Stafi

Pasi programi i studimit BA në Shkenca Kompjuterike do të organizohet për herë të parë në vitin akademik që fillon në vjeshtë 2014, ka një listë të shkrutër të ligjëruesve të caktuar për ligjërimitin e lëndëve. Shumica e tyre janë të lidhur me Universitetin e Prishtinës.

Duket se ky staf i mangët është i mjaftueshëm për të filluar vitin e parë akademik, mirëpo duhet të angazhohen staf me angazhim permanent. Sfida më e madhe e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike gjatë këtyre vietev etë para do të jetë rekrutimi i stafit permanent i cili do të merret me detyrat akademike. Një numër më i madh i stafit akademik do të sigurojë një stabilitet akademik si dhe ligjërues të përkushtuar me lëndë të cilat lidhen me programin e studimit.

Hulumtimi

Në do universitet, shtë e rëndësishme që të sigurohet se iniciativat e hulumtimit janë të lidhura ngushtë me temat e mësimdhënies, të cilat oforjnë përgjigje dhe aktualizojnë rezultatet e t ëmësuarit. Kjo është një sfidë e përgjithshme e cila është prezentë në zhvillimin akademik.

Në raportin e vet vlerësimit është përfshieë një plan bazik për hulumtim. Ky plan thekson tri fushat kryesore të hulumtimit të cilat janë të lidhura qartë me programin e studimit.

Stafi permanent i organizuar në gripe të hulumtimit zakonisht kryen punën kërkimore. Si rezultat i takimit me ligjëruesit është parë se ka disa aktivitete fillestare të hulumtimit. Mirëpo veprimet e hulumtimit janë qartësisht të lidhura me stafin permanent dhe një bxhet stabil dhe hapësira të mjaftueshme. Dyja aspektet duhet të adroshen kur të fillohet me grupet kërkimore.

Bashkëpunimi Ndërkombëtarë

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për një universitet janë marrëveshjet dhe bashkëpunimet ndërkombëtarë. UGJ është një universitet shumë i ri dhe njëri nga qlëlimet e tij, ashtu sic është shprehur në planin strategjik për të arritur misionin e tij, është rritja e mobilitetë të studentëve dhe stafit akademik nga shtetet e tjera.

Në përshkrimin e programit të studimit, duket se nuk ka asnjë strategji të posaçme për ndërkombëtarizmin, përpos atij të shprehur në nivel të universitetit.

Financat dhe infrastruktura

Ashtu sic është thënë në takim me ligjëruesit dhe koordinatorët e programit, për momentin buxheti ndarë për programin nuk është aq i lartë. Duket se MASHT duhet të caktojë më tepër mësbetjetje financiar në të ardhmen e afërt.

Pasi që Fakulteti i SHkenave Kompjuterike është i ri, nuk janë vizituar hapësirat përpos hapësirave të përbashkëta të studentëve. Dy laboratorë specifikë të kompjuteërvë d të krijohen dhe do të përdorn për programn e studimit.

Duhet të ofrohet një hapësirë e caktuar në mënyrë që të sigurohet stabiliteti dhe cilësia minimale e programit të studimit.

Menaxhimi i Cilësisë

Institucioni ka procedura të përgjithsme të sigurimit të cilësisë të cilat derivojnë nga Universiteti, bazuar në një set të raportve finale të clat janë pjesë e folderëve të ligjëruesve. Përpo skësja nuk ka kërkesa specifike apo aktivitete të planifikuara për sigurimin e cilësisë.

Fakulteti ka siguruar s epërmbajtjet e secilës lëndë të përfshirë në programin e tudimiti janë vlerësuar.

Në mënyrë që të garantohet një proces korrekt i sigurimit të cilësië, fakulteti duhet të fillojë me procedurën e mbledhjes së opinionëve të studentëve dhe ligjëruesve për aspektet e ndryshme akademike (rezultate e të mësuarit: si transmetohen ato dhe si arrihen ato, vlerësimi, ngarkesa e studentëve...).

Rekomandime

- Programi i studimit duhet të allafaqoëht me kornizat e mirënjohura si ACM/IEEE "Kurrikulat për Kompjuterë" apo EURO-INF.
- Të përkufizohet se si prkatkat janë të përfhsira në kurrikulë, duke i dhënë mudnësinë stduentëe që të dijnë se si të arrijën dhe ti njohin këto aktivitete.
- Të përkufiozhet një set i kompetencave të përgjithshme dhe kompetencave teknike specifike për programin, në mënyrë që rezultate e të mësuarit të identifikohen për secilën lëndë.

- Të ofrohet dhe përdoret një plat formë e të mësuarit ku ligjëruesit dhe studentët mund të ndajnë dhe të monitorjnë aktivitetet akademike.
- Të sigurohet se stafi permanent është i angazhuar për programin e studimit në mënyrë që aktivitetet e hulumtimit dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë të mund të organizohet.
- Të hartohet një plan real në mënyrë që të merren fonde dhe urime në mënyrë që programi i studimeve të jetë stabil.
- Të hartohen procedurat bazike për menaxhimin e cilësisë, me anë e pyetësorëve për profesorët dhe studentët, në mënyrë që të merret opinioni për aspekte akademike. Procedura bazë duhet të çojë në përmirësimin e organizimit të mësimdhënies dhe mësimarrjes.

Propozime për akreditim

Eksperti propozon akreditimin me kusht të programit BA Shkenca Kompjuterike të organizuar nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike.

Fakulteti duhet të zgjidhet pikat kritike si në vijim:

- Përkufizimin e kompetencave të përgjithshme dhe specifike teknik për programin e studimit. Duhet të lidhen rezultatet e të mësuarit për secilën lëndë.
- Përfuizimin e kurikulës për përdorimin e praktikës, e cila njihet dhe përdoret nga studentët.
- Organizimi dhe përmirësimi i gapësirave në mënyrë që ato të pranohen nga studentët. Të organizohen dhe pajisjen laboratorët e kompjuterëve për lëndë rrethore. Grupet e ardhshme të hulumtimit mund të punojnë në këtë laborator.
- Të definohet një plan strategjik për ndërkombëtarizim.
- Të krijohen minimum tre grupe të hulumtimit me tema specifike dhe iniciativa të cilat mund të vlerësohen.
- Të arrihet ndarja e buxhetit për fakultetin.
- Të fillohet me hartimin e një rregulloreje bazë për Menaxhimin e Cilësisë.

4. PROPOZIMI PËR AKREDITIM

Ekspertët propozojnë me kush akreditimin e UGJ-së. Universiteti duhet që brenda një vit të bëjë zgjidhjen e këtyre pikave kritike:

1. Caktimi i ECTS-ve duhet të jetë i qartë dhe transparent. Porfesorët duhet të konkretizojnë ngarkesën për programin akademik të studentëve.
2. Të krijohen strategji për zhvillimin e programeve të hulumtimit, pak a shumë të ketë programe të definuara mirë për hulumtim në të cilat programe duhet të përfihen sa më shumë profesorë që të jetë e mundur. Këto aktivitete të hulumtimit duhet të koordinohen nga pro rektori i Universitetit.
3. Të krijohet zyra për marrëdhëniet ndërkombëtare e cila do të koordinojë gjitha planet strategjike të ndërkombëtarizimit dhe të ofrojë gjitha masat lehtësuese për studentët dhe profesorët që qëndrojnë dhe studiojnë në universitete të tjera.
4. Është absolutisht e nevojshme që të rekrutohet më tepër staf permanent akademik në të gjitha fakultet përfhirë profesorë nga jashtë Kosova (BE, SHBA, etj.) në mënyrë që të vihen standarde shkencore ndërkombëtare dhe institucioni të fitojë një reputacion të lartë akademik. Kjo ndihmon edhe në marrëdhëniet institucionale për hulumtim, mobilitetin dhe shkëmbimin e studentëve dhe stafit mësimdhënës.
5. Duhet të përkufizohet një grumbull i qartë dhe real i kompetencave si përpjesën e përgjithshme ashtu edhe për pjesën specifike, në mënyrë që rezultatet e të mësuarit janë të lidhura dhe të aplikuar për secilën lëndë.
6. Duhet të hartohen një rregullore bazë për Sigurimin e Cilësië. Kjo rregullore e cila duhet të jetë me pëlqimin e universitetit dhe AKA-ë duhet të monitorojë dhe përmiësojë procesin e mësimdhënies – mësimmarrjes. Procedurat standarde të EFQM apo ISO 9001:20000 TË Sistemeve për Menaxhimin e Cilësië, duhet të ndjeket.

7. Të krijohet një protokoll apo proces i vendimmarrjes nëmnyrë që të monitorohet veprimi gjitha trupave qeverisës në Universitet.
8. EE i bën thirrje UGJ-së që të investojë tepër shumë në aktualizimin e librave të cilat lidhen me programet nën vlerësim. Secili libër i cili është paraqitur në syllabus duhet të jetë në paku nga një kopje në bibliotekë dhe duhet të aktualizohet në baza të rregullta.
9. Të investohet në databaza specifike dhe hulumtimin e studentëve në ëndët ofruara nga prograi. Së paku një databazë për seilin fakultet dhet të jetë e qasshme për studentët dhe për stafin akademik. Nj ëlaternativë e mundshme është qasja përmes konsorciumit në mes të bibliotekave të Kosovës.
10. Të investohet në hapësira të reja të cilat do të ndërtohen me fokus në nevojat e procesve edukative. Menaxhmenti i UGJ-së dhe arkitektët duhet të punojnë ngushtë me stafin mësimdhënës gjatë punimit të japëisrave për qëllimet e mësimdhënies. Vizita e në disa nga universitetet lidere evropiane mudn të shërbejë si inspirim për të veruar kështu.
11. UGJ duhet të fokusohet në zbatimin e [programeve me cilësi të lartë të cilat aktualisht ofrohen mirëpo institucioni nuk duhet të ofrojë programe të reja përderisa nuk është degë akademike e Universitetit të Prishtinës.

Përmbledhje e propozimeve për akreditimin dhe riakreditimin e programeve:

- Bachelor në Juridik: të akreditohet për një vit me rekomandimet dhe kushtet që duhet të përmbushen.
- Bachelor në Banka, Financa dhe Kntabilitet: riakrediohet me rekomandime.
- Bachelor në Marketing: riakrediohet me rekomandime.
- Master në Administrim Biznesi: nuk mund të rekomandohet për akreditim.
- Master në Menaxhment dhe Informatikë: të akreidothet për një vit me rekomandimet dhe kushtet që duhet t ëplotësohen.

- Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare: të akreditohet për një vit me rekomandimet dhe kushtet që duhet të plotësohen.
- Bachelor në SHkena Kompjuterike: të akreditohet pas asnjë kusht.